



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:181718

Datë: 15.02.2023

Numri i dokumentit: 03983124

C.nr.1029/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, sipas gjyqtarit individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e praktikantes Tringa Jashari, në çështjen juridiko-civile të paditëses M. B.-M. nga Lipjani, të cilën me autorizim e përfaqëson Egzona Gashi av. nga Lipjani, me autorizim, ndaj të paditures Komunës së Lipjanit – Drejtoratit Komunal të Arsimit, të cilën e përfaqëson Fatime Mustafa av. publike, me autorizim, përshkak të kompenzimit të t'ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.14.02.2023, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në pjesërisht kërkesëpadia e precizuar e paditëses M. B. – M. nga fsh. B. i M. K. Lipjan, si e **BAZUAR**, si dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Arsimit në Lipjan, që paditëses t'ia paguajë në emër të shujtës ditore për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 shumën prej 1,918.-€, dhe kamaten për këtë shumë në lartësi prej 477.49.-€, shpenzimet e udhëtimit për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 t'ia paguaj shumën prej 671.30.-€, dhe kamatën për këtë shumë në lartësi prej 167.12.-€, dhe diferencën e kompensimit ne emër të kualifikimit për periudhën 18.04.2017 deri me dt.21.01.2021 shumën prej 2,158.78.-€ dhe kamatën për këtë periudhë 18.04.2017-09.02.2023 shumën prej 955.38.-€ si dhe në emër të inflacionit shtesë në pagë për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 t'ia paguaj shumën prej 1,060.59.-€, këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e aktgjykimit 14.02.2023 e deri te pagesa definitive, poashtu t'ia paguaj Trustin Pensional në shumë prej 355.20.-€ si dhe Tatimin në burim në buxhetin e Republikës së Kosovës shumën prej 241.04.€ si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 742.40.-€, e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të ketij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II.REFUZOHET si e pabazuar, pjesa tjetër e kërkespadiës sa i përket kompensimit ne emër të licencimit shtesën në pagë për periudhën 22.01.2021 deri me dt.23.11.2022 shumën prej 920.00.-€ dhe kamatën për periudhën 22.01.2021 deri me dt.09.02.2023 shumën prej 86.49.-€.

A r s y e t i m

Paditësja M. B.- M. nga fsh. B. i M. K. Lipjani, në këtë gjykatë përmes të autorizuarës së sajë, ka ushtruar padi ndaj të paditures Komunës së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të të ardhurave personale.

Në padi si dhe me parashtresën për precizimin e kërkespadiës, e autorizuar e paditëses ka theksuar se paditësja është në marrdhënie pune si mësuese klase në SHFMU“ V. F.” në Lipjan, dhe ka kërkuar kompensimin e shujtës ditorë në shumë prej 1,918.-€, për periudhën nga dt. 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022, duke ia llogaritur kamatën në lartësi 8 % për periudhën 18.04.2017-09.02.2023

në shumë prej 477.49.-€, shpenzimet e udhëtimit për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 t'ia paguaj shumën prej 671.30.-€, me kamatën në lartësi prej 8 % për periudhën 18.04.2017-09.02.2023, në shumë prej 167.12.-€, dhe diferencën e kompensimit ne emër të kualifikimit për periudhën 18.04.2017 deri me dt.21.01.2021 shumën prej 2,158.78.-€ dhe kamatën për këtë periudhë 18.04.2017-09.02.2023 shumën prej 955.38.-€ ,në emër të inflacionit shtesë në pagë për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 t'ia paguaj shumën prej 1,060.59.-€ si dhe licencimin e shtesës në page për periudhën 22.01.2021 deri me dt.23.11.2022 shumën prej 920.00.-€ dhe kamatën për periudhën 22.01.2021 deri me dt.09.02.2023 shumën prej 86.49.-€, duke përfshirë edhe Trustin Pensional në shumë prej 355.20.-€ si dhe Tatimin ne burim në shumë 241.04.-€. të gjitha këto me kamatë ligjore.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditëses ka deklaruar se mbetet edhe më tutje deklarimave të theksuara në padi, seancat e kaluara si dhe precizimit të bërë, duke i propozuar gjykatës që e njejta të aprovohet ne tërësi si e bazuar. Më tutje ka shtuar se nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore u vërtetua se paditëses i takojnë shpenzimet e ushqimit për periudhën kontestuese për 959 ditë mësimi, shpenzimet e udhëtimit për vajtje ardhje në realcion Lipjan-Babush dhe anasjelltas për periudhën kontestuese në cmimin prej 1.-€, diferenca në emër të kualifikimit që është llogaritur nga ana e ekspertit, në emër të licencimit shtesën në page për periudhën kontestuese në shumë prej 920.-€ si dhe kamatën në shumë prej 86.49.-€, poashtu paditëses i takon edhe shtesa ne emër të rritjes së shkallës së inflacionit që është llogaritur në bazë të pagës bazë për paditësen për periudhën kontestuese, nga ana e ekspertit financiar, kërkesa këto të paditëses nuk janë paguar nga e paditura e që burojnë nga dispozitat e nenit 35.5, 35.7, 35.10 të KKAK-së, andaj i ka propozuar gjykatës që e paditura të detyrohet ti paguaj këto kërkesa paditëses mbi bazën e nenin 2 par.2 të KKAK-së. Gjithashtu ka shtuar se baza juridike e kërkespadisë sa i përket shtesës ne emër të kualifikimit përveq që parashihet që parashihet me nenin 7 të KKAK-së të vitit 2017 paditëses kjo e drejtë i takon edhe në bazë të pikës 4 të Vendimit të Qeverise se RKS-ës nr.1/33 të dt.29.08.2008, ku mbi bazën e këtij vendimi paditësja dhe gjithë të punësuarit marrin pagat në bazë të këtij vendimi dhe kualifikimi është përcaaktuar në pikën 4 të këtij vendimi në bazë të kriterëve të licencimit ku paditësja pjesërisht realizon të ardhura në bazë të këtij vendimi në bazë të kualifikimit por me rritjen e pagës bazë më nuk është rritur shuma e kualifikimit andaj eksperti financiar e ka bërë llogaritjen e diferencës së papaguar dhe kjo mund të vërtetohet edhe nga lista e pagave ku është përcaktuar lartësia e pagës bazë dhe ne emër të kualifikimit që realizon paditësi por jo mjaftueshëm sa është paga bazë andaj eksperti ka bërë llogaritjen bazuar në pagën bazë dhe këtë diferencë kërkojmë që paditësit ti paguhet.

Shpenzimet e procedures i ka kërkuar sipas TOAK-së, te specifikuara në shkresën për specifikacionit të shpenzimeve.

Në të përgjegjur në padi si dhe në shqyrtimet gjyqësore e paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e pales paditëse me arsyetimin se çështjet e kërkuara në padi janë pa bazë ligjore dhe se paditësja është punësuar tek e paditura dhe askund në kontratën e punës nuk ceket se punëtori i gëzon këto të drejta dhe paditësja i ka nënshkruar këto kontrata dhe është pajtuar me kushtet e kontratës si dhe detyrimet që i përmban. Poashtu as me Ligjin e Punës i cili rregullon kontestet e punës nuk ceket askund se punëtorëve iu takon kompensime të tilla, andaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike.

Ndërsa shqyrtimin kryesor gjykata e mbajti në mungesë të t'paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt konform nenit 423.4 të LPK-së.

Shpenzimet e procedures nuk i ka kerkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në proceduren e provave ka bërë administrimin e provave dhe ate me shiqimin dhe leximin e kontratës se punës e dt.01.09.2015, me shiqimin dhe leximin i kërkeses drejtuar të paditurës së dt.18.12.2020, me shiqimin dhe leximin i vërtetimit për ditët e pranisë në punë nr.../2023 i dt.23.01.2023, me shiqimin dhe lezimin e vëretimit të udhëtimit i dt.10.02.2023 lëshuar nga G. Trans, me shiqimin dhe leximin e ekspertizës financiare të ekspertit Halil Mustafa e dt.13.02.2023 dhe lista e pagave, me shiqimin dhe leximin e

diplomës të dt.31.05.2021 së bashku me licencimin, e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a) Se paditësja M. B.-M. nga fsh. B. i M. K. Lipjan ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura ne SHFMU "V.F." në Lipjan, si mësuese klase, dhe nga periudha 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 e njëjta ka gjithësejt 959 ditë pune.

b) Se për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.23.11.2022 ka udhëtar paditësja në relacionin L. – B. dhe anasjelltas, për ditët e pranisë në punë dhe ne emër të shpenzimeve të udhëtimit prej 70 % e njëjta ka shpenzuar shumën prej 671.30.-€ duke llogaritur edhe kamatën për këtë shumë deri me dt.09.02.2023 prej 167.12.-€.

c) Se për periudhën 18.04.2017 e deri me 23.11.2022 e njëjta ka pasur inflacion në të ardhura të pages bazë në shumën prej 1,060.59.-€.

d) Se e paditura ne emër të kualifikimit në bazë të vendimit nr.01/33 të dt.29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është dashur t'ia paguaj diferencën në pagën bazë prej 27 % dhe se e paditura ia ka paguar paditësit vetëm shumën prej 58.32.-€ në muaj.

f) Se për periudhën 18.04.2017 e deri me 21.01.2021 i takon diferenca e kompensimit shtesë të pagës bazë ne emër të kualifikimit (27% të pagës bazë) në lartësi prej 2,158.78.-€ dhe kamata për këtë shumë nga dt.18.04.2017 e deri me dt.09.02.2023 në lartësi prej 955.38.-€, duke ia zbritur shumën të cilën e ka realizuar e paditura si në pikën d).

Faktin nën a) gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës së dt.01.09.2015 e lidhur në mes paditëses dhe të paditueses si dhe vërtetimi i ditëve të punës nr.../2023 i dt.23.01.2023.

Faktet nën b), c) dhe d), gjykata i vërtetoi nga vërtetimi i udhëtimit i dt.10.02.2023 të lëshuar nga Kompania transportuese "G. Trans" dhe ekspertiza financiare e ekspertit Halil Mustafa të dt.13.02.2023 si dhe faktin nën c) dhe nën d) ku i njëjti ekspert ka përcaktuar shkallën e inflacionit të pagës bazë bazuar në entin e statistikave të Kosovës dhe lista e pagës.

Faktin nën f) gjykata e vërtetoi në bazë të diplomës së dt.31.05.2021 dhe ekspertizës të ekspertit financiar Halil Mustafa të dt.13.02.2023, i cili ka llogaritur diferencën mes shumës së paguar nga e paditura dhe shumës që duhet paguar bazuar në pagën bazë.

Me paragrafin 7 të nenit 35 te Kontratave Kolektive parashifet se "Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë dhe ate 2.-€ në ditë". Poashtu me paragrafin 10 të nenit 35 është paraparë që për cdo vitë të përcjelllet shkalla e inflacionit e që përcakohet në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës.

Me paragrafin 5 të nenit 35 të Kontratës Kolektive parashifet se "Punonjësvë arsimor që udhëtojnë ne vendbanimet e komunes përkatëse ku punojnë, iu takon kompensimi prej 70 % të biletës së trafikut urban".

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të dt.29.08.2008 parashifet se nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimsdhënësve etj do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimsdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se "Pjesmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij". Ndërsa me dispoziten e nenit 245 po të njejtit Ligj parashihet se "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegjëje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij".

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartëcekura gjykata vjen në përfundim se e paditura përkundër kërkesës së bërë nga paditësja nuk ia ka paguar këto të drejta që i

takojnë paditëses andaj gjykata vendosi që ta aprovoj kërkespadinë e precizuar të paditëses dhe vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kompensimit në emër licencimit shtesë në pagë për periudhën 21.01.2021 deri me dt.23.11.2022 dhe kamatën për këtë të drejtë, gjykata e refuzoj kërkespadinë e precizuar të paditësit si të pabazuar me arsyetimin se baza juridike e kësaj kërkesë nuk ekziston në asnjë dispozitë ligjore, respektivisht dispozita e nenit 7 e Kontratës Kolektive nuk ka karakter imperative, andaj nga këto arsye kërkesën e paditëses për kompenzimin në emër të licencimit e refuzoi si të pabazuar për cka vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditures të theksuara në përgjigje ne padi dhe seancën përgaditore, mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se Kontratata kolektive të Arsimit kanë qenë në fuqi për kohën sa ka kërkuar paditësja përmbushjen e kërkesës dhe e detyrojnë punëdhënësin e fundit për pagesë dhe e paditura duhet dhe ka për detyrim t'i përmbahet të njëjtave nga se të njëjtat janë në pajtim me Ligjin e Punës dhe po ashtu me nenin 46 të Kontrates Kolektive të dt.18.04.2017 dhe nenit 45 të Kontratës Kolektive të dt.22.01.2021 është paraparë që MASHT-i dhe SBASHK-u angazhohen për t'i informuar Komunat që me kohë të bëjnë planifikimin e buxhetit për zbatimin e këtyre të drejtave dhe po ashtu të angazhohen në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunat me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Sa i përket kualifikimit pra shtesës të pagës bazë për kualifikim gjykata i pati parasysh qëndrimet e gjykatave më të larta ku kanë dhënë mendime se kjo e drejtë nuk iu takon në bazë të nenit 7 të KKAK-së, sepse kjo dispozitë nuk ka karakter imperativ, mirëpo gjykata këtë të drejtë e gjykoj siç u tha më lartë në bazë të Vendimit të qeverisë për rritje të cili vendim është ende në fuqi dhe mbi bazën e këtij vendimi janë përcaktuar pagat dhe mbi këtë bazë ende mësimdhënsit i marrin pagat nga punëdhënsi mirëpo shtesa në emër të kualifikimit paguhet edhe tani por me një shtesë të llogaritur më parë ku paga bazë ka qenë më e ulët dhe me rritjen e pagës bazë nuk është rritur shtesa në kualifikim andaj eksperti financiar e ka bërë llogaritjen vetëm të diferencës të shtesës në kualifikim.

Vendimi për kamatan ligjore u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Meqenëse palet paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyroj të padituren që paditësit t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë, në shumë prej 104.00 €, për pecizimin e padisë shumë prej 104.00.-€, për një parashtrësë për zgjerim të kërkesëpadisë shumë prej 104.-€, për 2 seanca gjyqësore të përfaqësuar nga i autorizuari i pales paditëse shumë prej 135.20.-€, në tërësi shumë prej 270.40.-€, për ekspertizë financiare shumë prej 100.-€ si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 60.-€, apo shumë prej 742.40.-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për cka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe nenit 136 të LMD-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN.

C. nr. 1029/2020 me dt. 14.02.2023

**GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.